



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 189

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 38 ID, DATË 19.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT/KSHH**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

SUBJEKT: **Zj. Antoneta Çunaj**
Kryetar i Këshillit Bashkiak Fier

Z. Arnando Çupa
Sekretar i Këshillit Bashkiak Fier

OBJEKT: Lidhur me veprimtaritë publike të ndaluara në Bashkinë Fier, për miratimin e akteve nënligjore nga Këshilli i Bashkisë Fier

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

KONSTATOJ:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit/ KSHH, më datë 19.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 38 ID.

Në këtë denoncim Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtron sa vijon:

Data: 25.02.2025

Nr: 189
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 38 ID, datë 19.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të KSHH”

“Konkretisht, në njoftimin e datës 22.01.2025 të Këshillit Bashkiak Fier, janë vendosur në rendin e ditës dy projektvendime për dhënien me qira të disa trojeve në fshatrat e kësaj bashkie pika 15 dhe 16 konkretisht:

- 1. Projektvendim “Për miratimin e dhënies me qira të sipërfaqes tokë pa frut në fshatin Hasturkas, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier”.*
- 2. Projektvendim; “Për miratimin e dhënies me qira të pasurive Nr.9/10 zk. 3358, zk.1273 ndodhur në fshatin Bregas, Njësia Administrative Frakull, Bashkia Fier, të llojit tokë arë, në pronësi të Bashkisë Fier.*

Sipas nenit 9,1 pika 4, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar dhe nenit ,3 pika 3, e vendimit nr. 9, të Rregullatorit, të ndryshuar këto akte përbejnë veprim të ndaluar të shprehur në formën e “dhënies së pasurive”.

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

- Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Antoneta Çunaj, Kryetar i Këshillit Bashkiak Fier;
 - Z. Armando Çupa, Sekretar i Këshillit Bashkia, Fier.
- Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI